



UNIVERSITETI - UNIVERSITY

"ISA BOLETINI"
MITROVICË

Fakulteti Ekonomik

Pranuar më dt. 01.11.2021			
Njesia organ.	Numer	Nr.Ekzempl.	Vlera
	19311		

Këshilli i Fakultetit Ekonomik, në mbështetje të në mbështetje të nenit 72 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, nenit 8 të Rregullores nr. Prot. 1670, dt. 28.09.2021 për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë, dhe nenit 22 pika 1 të Rregullores mbi zgjedhjet në Universitetin e Mitrovicës dhe punën e Këshillit të Fakultetit më datë 29.10.2021 merr këtë:

VENDIM

- **REFUZOHET** Raporti i Komisionit vlerësues për **Një asistent për lëndët: Gjuhë angleze, anglishtja biznesore.**

Arsyetim

Këshilli i Fakultetit Ekonomik në mbledhjen e mbajtur më datë 29.10.2021 ka shqyrtuar raportin e komisionit vlerësues të emëruar nga Këshilli i Fakultetit Ekonomik, sipas konkursit të shpallur nr. prot 1712 dt.01.10.2021 të UIBM, për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë.

Këshilli i Fakultetit ka pranuar raportin e komisionit vlerësues për këtë pozitë 5 ditë me vonesë. Po ashtu, raporti ka qenë i panënshkruar nga anëtarët e komisionit, pastaj Këshilli ka konsideruar se kandidati i propozuar nga Komisioni nuk i plotëson kushtet për angazhim meqenëse nuk është i fushës së ngushtë për të cilën është shpallur konkursi. Andaj, me vendim të anëtarëve të Këshillit është vendosur që raporti të refuzohet. Kjo duke pasur parasysh dispozitat e Rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, e cila në nenin 8. Pastaj, dispozitat e nenit 12 të Rregullores për procedurat e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në UIBM.

I dorëzohet:

Zyrës për çështje akademike
Arkivit të fakultetit

Kryesuesi i Këshillit të Fakultetit

Prof. Asoc. Dr. Qazim Tmava

